



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 7288/2 prot.

Tiranë, më 18 .10 .2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. Nr.1051/1, datë 13.06.2017.

**SHOQËRISË “KOLOSIAN KRISTAL” SH.P.K**

**Banesë private 2 katëshe, kati i 2-të, pranë Qafë Kolosian, Bicaj, Kukës**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë**

Shoqëria “KOLOSIAN KRISTAL” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1051/1, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektivin “Përroi Thatë”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4280, datë 19.09.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 7288 Prot., datë 20.09.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1051/1, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektivin “Përroi Thatë”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në

Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1051/1, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektin "Përroi Thatë", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1051/1, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektin "Përroi Thatë", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
DHE  
MINISTRI**

**BELINDA BALLUKU  
ME URDHËR PËR DELEGIM  
ZËVENDËSMINISTRI  
CENO KLOSI**

